



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 1663/1 Prot

Dt. 21.03.24

Nr.211/1prot.

Shkodër, më 18.



LËNDA: Mbi vendimin nr. 13, datë 27.02.2024 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejes.


KËSHILLIT BASHKIAK VAU-DEJES

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, gërma a, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshur, neni 24, neni 54, neni 55, neni 64/c, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu III, ligjit nr.68/2017 “per financat e veteqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 20 pika 1 dhe 5, ligjit Nr.9936 datë. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetorë” i ndryshuar, VKB Vau-Dejës Nr.91 date.21.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afat-mesëm 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau-Dejës”, shqyrtoi **VKB Vau-Dejës nr.13 dt.27.02.2024** “Mbi miratimin e shtesës së planit në shumën 3.630.976 lekë me tvsh, në VKB Vau-Dejës Nr.91 date.21.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afat-mesëm 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau-Dejës, sipas shkresës Shkresës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr.807/17 datë.12.02.2024”.

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni, konform procedurave të mëtejshme ligjore. Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK
V E N D I M



Nr. 13 datë 27.02 2024

“PËR MIRATIM SHITESË PLANI NË BUXHETIN E BASHKISË VAU DEJËS TË MIRATUAR ME VKB-NË NR.91, DATË 21.12.2023 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PERFUNDIMTAR 2024-2026, NUMRIN E PUNJONJËSVE TË BASHKIAË VAU DEJËS”.

Në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; neni 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat vendore”; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; pika 190 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar; VKB-në Nr.91, datë 21.12.2023 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2024-2026, numrin e punjonjësve të Bashkiaë Vau Dejës”, Shkresës Nr. 807/17Prot, datë 12.02.2024 me lëndë “Njoftim”, dhe Relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës;Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

1. Miratimin shtesës së planit të buxhetit të bashkisë Vau Dejës, për projektin “Shërbim Lëvizës në familje, për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar në Bashkinë Vau-Dejes”. Projekti financohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, programi i Fondit Social, Ky projekt do të përfshihet në programin 10430 “Kujdesi Social” shuma totale per vitin 2024; 3,630,976 (Tre milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë me TVSH.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Kryetar Këshilli
Ervis Shimaj



Sekretar Këshilli
Ardian Çelepja

Miratuar me 20 vota

Vota Pro 20

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 04.03.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

DREJTORIA E MBROJTJES PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL

PROJEKT VENDIM

Nr 02 datë 16.02.2024

“PËR MIRATIM SHITESË PLANI NË BUXHETIN E BASHKISË VAU DEJËS TË MIRATUAR ME VKB-NË NR.91, DATË 21.12.2023 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PERFUNDIMTAR 2024-2026, NUMRIN E PUNJONJËSVE TË BASHKIAË VAU DEJËS”.

Në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; neni 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat vendore”; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; pika 190 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar;; VKB-në Nr.91, datë 21.12.2023 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2024-2026, numrin e punjonjësve të Bashkiaë Vau Dejës”, Shkresës Nr. 807/17Prot, datë 12.02.2024 me lëndë “Njoftim”, dhe Relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës; i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të :

VENDOSI

1. Miratimin shtesës së planit të buxhetit të bashkisë Vau Dejës, për projektin “Shërbim Lëvizës në familje, për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar në Bashkinë Vau-Dejes”. Projekti financohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, programi i Fondit Social, Ky projekt do të përfshihet në programin 10430 “Kujdesi Social” shuma totale per vitin 2024; 3,630,976 (Tre milion e gjashtwqind e tridhjetë mijë e nwnwqind e shtatwdhjetw e gjashtw) lekë me TVSH”, sipas shkresës Nr. 807/17Prot, datë 12.02.2024, sipas detajimit me poshtë:

1. Shpenzimet e llogaritura				
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024.	Totali (Lekë)	Nga kjo:		
		Paga	Operative	Transferime



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Burime Njerezore					
<i>Kontribut Bashkia</i>					
<i>Fondi Social</i>	3,620,976	3,620,976			
Pajisje dhe furnizime					
<i>Kontribut Bashkia</i>	200,000				200,000
<i>Kontribut donatori</i>					
Shpenzime per aktivite					
<i>Kontribut Bashkia</i>	375,900		375,900		
Shpenzime per vizibilitetin					
<i>Kontribut (Fondi Social)</i>	10,000		10,000		
Shuma	4,206,876	3,620,976	385,900		200,000

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi:

Çuka Bobani : Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Social dhe Mbrojtjes së Fëmijëve.

Miratoi:

Ridvan Luzaku : Drejtor/ Drejtoria e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social.

Shefqet Rexhepi : Drejtor/ Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar.

KRYETAR
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETAR

Gjovani ZEFI



Konfirmoi Bazën Ligjore: *Jashin Shteti* : Përgjegjës/Spektori i Asistencës Ligjore, Kontratave dhe Çështjeve Gjyqësore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA E MBROJTJES, PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL**

RELACION

**“PËR MIRATIM SHITESË PLANI NË BUXHETIN E BASHKISË VAU DEJËS TË
MIRATUAR ME VKB-NË NR.91, DATË 21.12.2023 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT
TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PERFUNDIMTAR
2024-2026, NUMRIN E PUNJONJËSVE TË BASHKIAË VAU DEJËS”.**

DREJTUAR : Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Të nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; neni 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat vendore”; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; pika 190 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar; Shkresës Nr. 807/17Prot, datë 12.02.2024 me lëndë “Njoftim”; VKB-në Nr.91, datë 21.12.2023 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2024-2026, numrin e punjonjësve të Bashkiaë Vau Dejës; Planit Social Vendor 2021-2023 miratuar me VKB-në Nr 84, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Planit Social Vendor të Bashkisë Vau Dejës”, Bashkia ka aplikuar me kërkesë për financim të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor më projektin “Shërbim Lëvizës në familje, për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar në Bashkinë Vau-Dejes”, në thirrjen e hapur nga Ministria e Shëndetësosë dhe Mbrojtjes Sociale në programin e Fondit Social 2024

Ky projekt ka një kohëzgjatje 36 muaj, dhe nëpërmjet shkresës Nr. 807/17, datë 12.02.2024, jemi njoftuar për kualifikimin e projektit i cili për vitin 2024 Bashkia dhe Ministria e Shëndetsise dhe Mbrojtjes Sociale ka vlera totale 4,206,876 (Katër milion e katërqind e dymbëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë me TVSH, nga te cilat Kontributi i (Fondi Social) nga Ministria e Shëndetsise dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2024 është ; 3,630,976 (Tre milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e nentëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë me Tvsh dhe Kontributi i Bashkise për vitin 2024 është ; 575,900 (Pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mije e nentëqind) Lekë me Tvsh.



Me anë të këtij financimi është planifikuar të realizohet;

Burime njerëzore; (Psikolog+Punonjës Social+Fizioterapist+Logope+Shofer) për ofrimin e shërbimit për 25 fëmije me aftësi të kufizuar, në shumën 3,620,976 (Tre milion e gjashtëqind e njëzet mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë)Lekë; Pajisje dhe furnizime, (Blerje kompjutera) ne shumën 200,000 (Dyqind mijë) lekë; shpenzime për aktivitete (trajnime te stafit dhe nafte karburant) ne shumën 375,900 (Treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind) leke; (vizibilitet) ne shumën 10,000 (Dhjetë mijë)Lekë.

Rezultatet e këtij projekti do të jenë;

A. 1.Përzgjedhjen e Njesisë Lëvizëse (rekrutimin e stafit sipas nevojës punonjës social dhe logoped). Kjo njësi përbëhet nga katër specialiste (1 psikolog, 1 punonjës social, 1 logoped, 1 fizioterapist) dhe një shofer.

2.Pas ngritjes së njesisë lëvizëse, stafi i rekrutuar kalon në një set trajnimesh që rrisin aftësitë e tyre në dhënien e shërbimit në kushte shtëpiake duke e parë aftësinë e kufizuar në lentet e modelit biopsikosocial.

3.Stafi ka të gjithë infrastrukturën e domosdoshme për ofrimin e shërbimit sipas standarteve

B. 1.Njësia lëvizëse në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror (SHSSH) do të analizoje 25 Fëmijët me Aftësi të Kufizuar që do tu ofrohet shërbimi në hapësirën në shtëpi. Sigurisht palët zbatuese kanë vendosur paraprakisht disa kritere që ndihmojnë evidentimin e vijimsisë së shërbimit sipas nevojave të përfituesve. Fëmijët dhe familjet që do tu shërbehet bëhet komunikim për vijimsinë e ofrimit të shërbimeve dhe rimerret dakortësia për shërbimin në shtëpi të kujdestarit ligjor dhe përfituesit.

2.Shërbimi në shtëpi fillon me procesin e vlerësimit. Njësia lëvizëse e lehtëson këtë proces vlerësimi. Pasi vlerësohen nevojat e fëmijës dhe familjes do të zhvillohet një Plan Zhvillimi Individual (PZHI) i cili dakortësohet me kujdestarin e fëmijës me Aftësi të Kufizuar. Gjatë vlerësimit dhe hartimit të planit të zhvillimit ekipi i specialisteve ndërvepron/konsultohet me specialistët që e njohin rastin e fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe familjes. Njësia lëvizëse do të jetë duke ofruar shërbim sipas një kalendari të miratuar paraprakisht si dhe do të mbështesë anëtarët e familjes / kujdestarët për të kryer dhe mirëmbajtur terapinë me aktivitete që mund të bëhen në shtëpi, duke mundësuar kështu në zhvillimin e potencialit të fëmijës me aftësi të kufizuar. Çdo përfitues shërbimi ka dosjen e tij në të cilën janë pasqyruar vlerësimet dhe planet e zhvillimit, të cilat rishikohen çdo gjashtë muaj. Puna e ekipit të Njesisë Lëvizëse do të mbështetet në standartet e Udhësimit Nr 355, datë 02.06.2022.

C. Ky objektiv synon të permirësojë mjedisin shoqëror ku fëmijës i duhet të zhvillojë potencialin e tij. Thelbi i kësaj ndërhyrje është respektimi i të drejtave të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar përmes mbështetjes së familjes. Roli i familjes në aspektin e zhvillimit të Fëmijës me AK është vendimtar dhe studimi i aftësisë së kufizuar thekson nevojën e madhe për identifikimin, mbështetjen dhe shërbime të specializuara pa kosto (ose me kosto të përbalueshme) në këtë perspektivë, njësia lëvizëse ndërton plane zhvillimi për familjen 1- aftësimi i prindërve në zhvillimin e potencialit të fëmijëve të tyre 2-mbështetje emocionale; 3-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

mbështetje sociale ; 4- Rritja e ekonomisë dhe kushteve të jetesës duke ju dhënë mundësi prinderve që të mos shpenzojnë për terapi privatë apo për të levizur drejt qendrave në zona të largëta nga banimi i tyre të cilat për këto kategori janë të papërballueshme.

Prindërit, kujdestarët, vëllezërit e motrat e Fëmijës me Aftësi të Kufizuara që përfitojnë nga programi pasi mësohen dhe këshillohen nga njësi lëvizëse si të kryejnë ushtrime të thjeshta dhe të ndërtojnë disa aftësi që i ndihmojnë ata të kryejnë aktivitete që ndikojnë në zhvillimin e potencialit të fëmijës me AK sipas Planit Individual të Zhvillimit. Përveç kësaj, ndërhyrjet e programit planifikojnë të organizojnë sesione informuese nga punonjësi social dhe psikologu i ekipit për të informuar familjet mbi të drejtat dhe përgjegjësitë lidhur me legjislacionin dhe përfitimet që fëmija me aftësi të kufizuara ka, dhe i mbështesin në proceset që kanë të bëjnë me qasjen në arsim, shëndetësi dhe shoqëri

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi:

Çuka Babani

Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Social dhe Mbrojtjes së Fëmijëve.